



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

---

**Datë:** 14.07.2025  
**Numër Protokoll:** 4724/2025

**A.nr.980/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Sabile Avdyli-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.980/2025, të datës 27.05.2025 të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër Njoftimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit-Agjencisë së Statistika të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.07.2025 mori:

**V E N D I M**

**I.Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.980/2025, e datës 27.05.2025, e parashtruar nga ankuesi G.H.

**II.Mbetet në fuqi** Njoftimi Nr.01-03-594 i datës 13.05.2025 për kandidatët fitues, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit-Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi, G.H, i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit për pozitën “*Zyrtar i Statistikave*” në Zyrën e Kryeministrit-Agjencia e Statistikave të Kosovës, me datë 27.05.2025 ka parashtruar ankesë përmes emalit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjën A.nr.980/2025 me numër protokoll 3529/2025, kundër procedurës së rekrutimit dhe njoftimit të datës Njoftimi Nr.01-03-594 i datës 13.05.2025 për kandidatin fitues, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit-Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 12.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek ASK, ndërsa me datë 13.06.2025, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen administrative në procedurë. **Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)** për vendosje meritore administroi këto prova: **Kolegji për Shqyrtimin dhe**

**Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova:** Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës me nr.prot 980/2025 i datës 13.06.2025; Konkursi; Njoftimin për listën e ngushtë të datës 23.04.2025; Njoftimin për shpalljet e rezultatit përfundimtar të datës 13.05.2025; Njoftimin e datës 12.05.2025; Diplomën e E.Z të datës 08.12.2021; Diplomën e E.Z të datës 05.10.2017. Diplomën e ankuesit nr.1349 datë 05.11.2020;

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është **e pabazuar**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Zyra e Kryeministrit-Agjencia e Statistikave të Kosovës më datë 14.03.2025 ka bërë njoftimin për shpalljen e konkursit për “Grupi i Statistikave” për pozitën Zyrtar për Statistika klasa Profesional 2, me afat të aplikimit nga data 15.03.2025 deri më datë 13.04.2025 me nr. RN00017119, ndërsa kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Matematikë, Ekonomi, Gjeografi.*
- **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se konkursi me nr. RN17119 “Grupi i Statistikave” pozita Zyrtar për Statistika klasa profesional 2 është shpallur në pajtim me Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe katalogun e vendeve të punës e cila evidentohet me SHCK1448.

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit përmes njoftimit (pa datë) Njësia e Burimeve Njerëzore ia ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht kualifikimin arsimor, sepse ankuesi posedon diplomën me nr. 1349 të datës 05.11.2020 me të cilën ka përfunduar Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë drejtimi Baçellor në Ekonomia e Bujqësisë, dhe si rrjedhojë nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar më tutje në këtë proces të rekrutimit.

Kolegji, ka konstatuar se në përputhje me dispozitat e lartshënuara në këtë arsyetim sa i përket kualifikimit arsimor NJMBNJ në ASK ka vërtetuar drejtë argumentet faktike dhe gjendjen juridike kur ka vendosur të refuzoj aplikacionin e ankuesit sa i përket kriterëve të kualifikimit arsimor, sepse ankuesi nuk posedon diplomë në drejtimet e kërkuar nga shpallja e konkursit siç është thënë më lartë.

Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit se konkursi i shpallur nuk i përmban elementet të paraparë me dispozitat ligjore është i pa qëndrueshëm, sepse konkursi është i shpallur konform Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 7 ku përcaktohet se” **Parimet e pranimi në detyrë të zyrtares/it publik 1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese**” si dhe në harmoni me Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil respektivisht neni 5 ku përcaktohet se “ **Shpallja e procedurës së rekrutimit 1. Shpallja e procedurës së rekrutimit përmban të paktën këto të dhëna: 1.1. vendin e punës; 1.2. përshkrimin e përgjithshëm të punës; 1.3. kriteret e përgjithshme për**

*pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së; 1.4. kriteret specifike shitesë, nëse ka; 1.5. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të saktë; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët”*

**Po ashtu Kolegji ka vlerësuar edhe dosjen e kandidat fitues dhe ka konstatuar** Aplikacioni i E.Z e datës 08.04.2025; Diploma e E.Z e datës 05.10.2017 nga Departamenti për Menaxhment dhe informatikë (Fakulteti Ekonomik me Qendër në Prishtinë); Diploma e E.Z e shkollës së mesme e datës 07.07.2014; Diploma e E.Z e datës 08.12.2021 e fakultetit Ekonomik për Menaxhment dhe informatikë; Certifikatë e trajnimit e E.Z nga AFAS e datës 15.12.2020; Certifikatë e E.Z nga universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” e datës 31.12.2018; Certifikatë e pjesëmarrjes nga FIFO e datës 28.02.2018; Certifikatë për kontabilitet në praktikë me softuerin Rikont e datës 17.06.2021; Certifikatë nga ISP e datës 26.03.2011; Letër rekomanduese nga “Zogu i Bardhë” SH.P.K e datës 01.06.2017; Kontrata e punës për një kohë të caktuar nga INA SH.P.K e datës 01.09.2024 për periudhën 01.09.2024 deri më 31.12.2025, dhe, e datës 01.09.2019 për periudhën 01.09.2019 deri më 31.12.2023; Kontrata e punës nga Agjencia e statistikave të Kosovës e datës 25.06.2024; Kontratë për punë specifike nga Plan-A Consulting për periudhën 02.05.2023 deri më 03.08.2023; Kontratë e lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit e datës 16.03.2021 dhe 14.10.2020; Kontratë për kryerje e punës praktike profesionale nga Universitetit i Prishtinës “Hasan Prishtina” e datës 19.10.2018; Letër reference nga Ndërmarrja publike Banesore e datës 26.09.2024 për periudhën 11.10.2023 deri më 23.09.2024; Letër reference në gjuhën angleze nga Kaci Manninen e datës 28.02.2025; Letër reference nga zyra e Kryeministrit (Departamenti i Statistikave Ekonomike) për periudhën Nëntor-Dhjetor 2023; Letër rekomandimi nga Universiteti i Prishtinës e datës 26.12.2018.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia e Statistikave të Kosovës me rastin e zhvillimit të procedurave të konkursit për pozitën Zyrtar për Statistika ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe katalogun e vendeve të punës e cila evidentohet me SHCK1448.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë përbazë dispozitat e aplikuara të ligjit material, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, dhe pas konstatimit se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara, vendosi që ankesën e tij ta refuzoi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ka lënë në fuqi Njoftimi Nr.01-03-594 i datës 13.05.2025 për kandidaten fitues.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nënit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr. : 980/2025**

**Sabile Avdyli**

*Procesmbajtës*

**Eshref Shabani**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit: G.H;
- NjMBNJ në Agjencinë e Statistikave të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.